



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0920

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshorit Kryetare, duke vendosur sipas ankesës së OE) “BK – CONSTRUCTION” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E PEJËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1-Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Boge LOT 2- Ndertimi i ndricimit publik nga rrethi Vitomirice deri te shkolla (Rr.Hasan Muratagic)dhe ndricimi ne fshatrat Kotradiq,Kristal(Lagja e Bujupt)dhe Radac (Rr.Shaqir Demaj) LOT 3- Ndertimi i trotuarit dhe ndricimi publik ne fshatrat Loxhe(Rr.Deme Isufi)dhe ne rrugen Hida Halimi ne lagjen Dardania” me numër të prokurimit 635-24-8403-5-2-1, me 04/12/2024, mori:

Vendim

1.Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “BK – CONSTRUCTION” SH.P.K. me idhunr. 2024/0920, e datës 27/09/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1-Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Boge me numër të prokurimit 635-24-8403-5-2-1 inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - KOMUNA E PEJËS.

2.Anulohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues ndërsa aktiviteti i prokurimit si në pikën 1 të dispozitivit kthehet në **rivlerësim**.

3.Detyrohet Autoriteti Kontraktues për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 14.08.2024 “KOMUNA E PEJËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Boge LOT 2- ndërtimi i ndriçimit publik nga rrethi Vitomirice deri te shkolla (Rr.Hasan Muratagic)dhe ndricimi ne fshatrat Kotradiq,Kristal(Lagja e Bujupt)dhe Radac (Rr.Shaqir Demaj) LOT 3- ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik ne fshatrat Loxhe(Rr.Deme Isufi)dhe ne rrugën Hida Halimi ne lagjen Dardania” me nr. të prokurimit: 635-24-8403-5-2-1. Ndërsa me datën 13.09.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontratë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **LOT 1: 99.930.00 Euro**.

Me 18.09.2024, OE “**BK – CONSTRUCTION**” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 20.09.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27/09/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “**BK – CONSTRUCTION**” SH.P.K me nr. 2024/0920 për lidhur me aktivitetin“Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1- Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Boge LOT 2- Ndërtimi i ndriçimit publik nga rrethi Vitomirice deri te shkolla (Rr.Hasan Muratagic)dhe ndricimi ne fshatrat Kotradiq,Kristal(Lagja e Bujupt)dhe Radac (Rr.Shaqir Demaj) LOT 3- Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik ne fshatrat Loxhe(Rr.Deme Isufi)dhe ne rrugën Hida Halimi ne lagjen Dardania” me nr. të prokurimit: 635-24-8403-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BK – CONSTRUCTION” SH.P.K janë parashtruar si në vijim: "Me datën 13.09.2024 AK ka shpallur OE si OE i përgjegjshëm duke shpjer me këtë vendim në njoftim për dhënie të Kontratës OE i Cili nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e Kërkuara në DT. Pas Kërkesës për rishqyrtim të cilën e kemi paraqitur me datën 18.09.2024 ne kemi marr përgjigje nga AK me datën 20.09.2024 që pretendimet tona janë të

pabazuara. Fakt i cili nuk qëndron. Në vijim do ti përmendim disa nga vërejtjet: Vërejtja 1. OE shpallur fitues nuk ka ofertuar me dokumentacion të plotë ashtu siq është kërkuar sipas DT Kapaciteti teknik dhe profesional: Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë Lista që ka paraqitur OE është: Kjo listë dallon nga Aneksi i cili është kërkuar dhe ishte obligativ Pasi që ajo duket si më postë Aneksi 6. LISTA E KONTRATAVE TË REALIZUARA Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë Ndërkaq përgjigja e AK ishte lista e paraqitur nga OE ka përmbushur kërkesën e tyre dhe për këtë arsye kërkesa jonë ishte pa bazuar. Edhe pse shihet kuartë që disa tipare nga aneksi Obligativ në DT që është paraqitur mungojnë në listen e paraqitur nga OE. Për ing Faik Kurumeli është ofruar një diplomë e nivelit bachelor, e cila nuk është ekuivalente me nivelin të kërkuar në DT. Pasi aty ishte kërkesa të jetë ing I diplomuar ose master. Për pretendimin tonë të dytë në lidhje me diplomën Bachelor të Ing Faik Kurumeli që nuk i plotëson kushtet në DT pasi është kërkuar ing i diplomuar apo master. Ak ka dhen përgjigjen që ky ing është ing i diplomuar bachelor dhe plotëson kushtin në FTD. Edhe pse niveli bachelor nuk mund të jetë kur ekuivalent me nivelin e ing i diplomuar. Pasi që Bachelor është sipas sistemit të bollonies dhe ka 3 vite studimi, ndërkaq niveli ing i diplomuar ka më shume, që shpie edhe në më shume kredi në diplom. Dhe për këtë është e barasvlefshme diploma master. Të njëjtën gjë edhe ju si Oshp keni vërtetuar me vendimin e PSH 304/22. Prandaj nuk pajtohem me përgjigjen e AK ku vetë bie ndesh me kërkesën e saj. Pasi që ka kërkuar Një inxhinieri i diplomuar i ndërtimitarisë ose master konstruktiv dhe bachelor i nuk i përmbush asnjërin nga kërkesat. Përgjigja e AK në lidhje me këtë pikë nuk është aspak i drejtë. Dhe nuk është vlerësuar siç parashihet me LPP. Ku përveç që është shkelur neni 59 i LPP-së, nuk është respektuar as neni 7, paragrafi 1 dhe 2. Pasi që vlerësimi nuk është bërë siq duhet, Dhe në këtë formë është bërë edhe diskriminimi ndaj neve si OE. Kontratat e punët të ofruara në mesë të OE dhe teknik të elektrikes nuk janë fare të noterizuara. Edhe pse kërkesa ka qenë kontrata pune aktive të noterizuar ose marrëveshje për bashkëpunim e noterizuar. Përgjigja e AK-së në këtë pikë ishte që kontratat janë në pajtueshmëri me kërkesë në FTD. Më poshtë kemi paraqitur kontratat e panoterizuara të teknikëve të cilat sipas AK janë në pajtueshme me kërkesën kontrata pune aktive të noterizuar ose marrëveshje për bashkëpunim e noterizuar. Përgjigja e AK në lidhje me këtë pikë nuk është aspak i drejtë. Dhe nuk është vlerësuar siç parashihet me LPP. Ku përveç që është shkelur neni 59 i LPP-së, nuk është respektuar as neni 7, paragrafi 1 dhe 2. Pasi që vlerësimi nuk është bërë siq duhet, Dhe në këtë formë është bërë edhe diskriminimi ndaj neve si OE vërejtje e katër të; sipas kërkesës në DT OE duhet të jetë në gjendje të ofroj Staf i paraqitur nga OE që janë të paisur me certifikata Staf i me certifikata për siguri në punë : 1. Afrim Fejza -ing I Elektros; 2. Toni Krasniqi- Electricist, 3. Aldan Krasniqi- Drejtor; 4. Clirim Zogu - Teknik I elektros, 5. Habib Krasniqi - Electricist 6. Danush Krasniqi - Electricist 7. Mirjeta Hoxha - Kontabilist Vlen të theksojmë përveç që më lartë stafi teknik është kërkuar të jenë të pajisur me certifikata për siguri dhe mbrojtje në punë , ku vetëm dy prej tyre janë të panisur ndërkaq I treti jo. Më poshtë janë kërkuar të jenë 8 punëtor të pajisur me certifikata për siguri dhe mbrojtje në punë ndërkaq OE ka arritur të mbulojë vetëm me 7 punëtor këtë kriter Ndërkaq AK ka pretenduar që është i plotësuar sipas DT ky kriter edhe pse qartë shihet që një certifikatë mungon. Përgjigja e AK në lidhje me këtë pikë nuk është aspak i drejtë. Dhe nuk është vlerësuar siç parashihet me LPP. Ku përveç që është shkelur neni 59 i LPP-së, nuk është respektuar as neni 7, paragrafi 1 dhe 2. Pasi që vlerësimi nuk është bërë siq duhet, Dhe në këtë formë është bërë edhe diskriminimi ndaj neve si OE vërejtje pestë dhe e fundit është sigurimi I tenderit. IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit: Në njoftim për kontratë dhe në DT është kërkuar sigurimi I tenderit, ku vlerat kanë qenë ndaras për secilin lot veç e veç. Duke të bërë me dije që secili lot kërkon polis të

veçante dhe jo një polise të vetme. OE I shpallur fitues ka paraqitur një ploiste të vetme me shumë totale të secilit lot. Gjë e cila është në kundërshtim me nenin 57 të LPP-së. në këtë rastë kjo procedurë përmban kontrata të veçanta dhe nuk duhen të trajtohen si ndryshe. Edhe vet AK në kërkesë ka paraqitur kërkesë në mënyrë të veçante Vlerën e sigurimit për secilin lot. Dhe jo vlerë të përbashkët për të gjitha lotet. Një argument që është marë për një procedurë nga eksperti I Oshp-së në lëndën 2024/0702 është si më poshtë :1.Baza Ligjore:Sipas nenit 57 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), gjatë një aktiviteti prokurimi që çon në nënshkrimin e një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë sigurim (garantim) nga tenderuesit.2.Kërkesa për Sigurimin e Tenderit:Secili lot përfaqëson një kontratë të veçantë. Në këtë kuadër, kërkesa për sigurimin e tenderit për secilin lot është në përputhje të plotë me nenin 57 të LPP-së. Kjo kërkesë është vendosur për të siguruar mbrojtjen e duhur për autoritetin kontraktues për çdo lot të veçantë.Polisa e OE të shpallur fitues:Prandaj ky OE nuk ka paraqitur sigurim Tenderi Valid i cili është në përputhje të kërkesës në DT dhe për këtë arsye duhet të eliminohet.Ndërkaq përgjigja e AK në këtë rastë ishte që ky OE ka plotësuar kriterin e DT dhe që sipas komisionit vlerësues ishte në rregull gjithashtu ,Përgjigja e AK në lidhje me këtë pikë nuk është aspak i drejtë. Dhe nuk është vlerësuar siq parashihet me LPP. Ku përveç që është shkelur neni 57 i LPP-së.Duke pas faktin parasysh që ne si OE i përgjegjshëm, i cili i plotëson kushtet e parapara në DT jemi eliminuar padrejtësisht nga kjo procedurë. Kërkojmë nga ju që ky veprim të Rishqyrtohet, dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Pasi që me këtë veprim AK jo që vetëm na bënë dëm ne si OE, duke përfshirë këtu dëm të ndryshme financiaro-morale. Por i shkakton dëm edhe vetes, qoftë ai kohor apo ndoni dëm tjetër."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "BK – CONSTRUCTION" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 7, Neni 59, Neni 57, Neni , Ndërkaq nenet e shkelura nga A01 Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 40.6, Neni 41 , Prandaj duke u bazuar në ato që përshkruam më lartë ne nuk pajtohemi absolut me Përgjigjen e juaj të dt 20.09.2024. dhe për këtë arsye kërkojmë që të merret: VENDIM APROVIM i kërkesës për Rishqyrtim nga BC CONSTRUCTION SHPK Lidhur me tenderin : Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1-Ndertimi i ndriçimi publik Shkrel-Boge nr I prokurimit 635-24-8403-5-2-1 ANULIM i vendimit të AK dhe lënda të kthehet në RTVLERESIM. Ri-vlerësimi te behet ne baze te kërkesave te LPP. Ku pastaj do te duhej fituesi te shpallej BC CONSTRUCTION SHPK.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: "Operatori Ekonomik BK- CONSTRUCTION SH.P.K. me datën 18.09.2024, ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Boge me Nr. të Prok: 635-24-8403-5-2-1 nr i 635-24-050-5-2-1 nxjerr:Autoriteti Kontraktues, me datën 20,09.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: A.K pas analizës se kërkesës se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 18.09.2024 ,e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka ardhur ne përfundim se njëjta është e pa bazuar., Përgjigje e AK 1: Ju njoftojmë se ne si A,K dhe Komisioni i Ri-Vlerësues se ka vepruar konform LPP-se dhe RREGULLAVE sa i përket pretendimeve te juaja ankimore lidhur me ANEKSIN 6 nuk qëndrojnë pasi qe OE i propozuar për kontratë ka dorëzuar LISTEN E KONTRATAVE ku ne atë liste janë te cekuar qarte informatat e duhura si qe janë te kërkuara ne FDT : Foto 1 Mund te shihni qe i ka te ngarkuara ne sistem listën e projekteve te cekuara me emere projektit numër prokurimit

afatin data fillimit data e përfundimit: andaj me keqardhje ju njoftojmë se pretendimet e juaja ankimore ne këtë pike janë te pa bazuara Përgjigje nga AK 2: Sa i përket Ing FAIK KURUMELI, është ne përputhje me kërkesat e FDT-se pasi qe është kërkuara Një inxhinieri i diplomuar i ndërtimitarisë ose master konstruktiv me 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Ndërsa Ing Faik Kur Umeli është inxhinier i diplomuar bachellor me provoje 15 Vite pas diplomimit qe ne këtë raste ky e plotëson kërkesën e pare te FDT-se Një inxhinieri i diplomuar i ndërtimitarisë dhe plotëson provojnë qe është kërkuar 3 vite ndërsa ky e ka 15 vite provoj pune, sa i përket nënshkrimeve te CV-se dhe kontratës, mbetet ne përgjegjësi te OE ,andaj me keqardhje ju njoftojmë se pretendimet e juaja ankimore ne këtë pike janë te pa bazuara. Përgjigje nga AK 3: Te gjitha kontratat, certifikatat e dorëzuara nga OE TONIINGJINJERING janë ne pajtueshmëri me LPP-ne dhe i plotëson te kriteret e kërkuara sipas FDT-se ku janë te noterizuara siç është kërkuar, andaj me keqardhje ju njoftojmë se pretendimet e juaja ankimore ne këtë pike janë te pa bazuara. Përgjigja nga AK 4: Sigurimi i dorëzuar nga OE është ne përputhje me kërkesat e l-DT-se pasi qe OE ka dorëzuar një SIGURIMI TENDERIT ku vlera është sipas Kushteve te Dosjes se tenderit pra për LOT 1 është kërkuar sigurimin ne vlere prej 2.000.00 Euro për LOT 2 sigurimi ne vlere preje 1.000.00 Euro dhe për lot 3 Vlera e sigurimit është prej 3.000.00 Euro qe ne Total i bije te jete 6.000.00 Euro dhe sigurimin e ofruar nga OE është ne vlere prej 6.000.00 Euro qe për komisionin ri-vlerësues ka konstatuar qe është ne rregull dhe OE i propozuar për kontratë është i përgjigje me çmimin me te lire , andaj me keqardhje ju njoftojmë se pretendimet e juaja ankimore ne këtë pike janë te pa bazuara."

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0920/2024, ndërsa me datë 21.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0920 me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim*".

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore të OE "BK – CONSTRUCTION" SH.P.K

Pretendimi i parë - "*Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin qe ka te beje me - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale me FDT është kërkuar: Për (LOT-1) Kërkesa 1- Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të natyrës së ngjashme ne lëmine e ndriçimit publike në vlerë prej 140.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara. Për (LOT-1) -Dëshmia 1- Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës,*

datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat për kryerje të punëve., operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e kontratave në përputhje me kërkesat e përcaktuara në tabelën e Aneksit 6 të (FDT). Informacionet e përfshira në këtë listë kanë qenë të mjaftueshme dhe të sakta për të mundësuar një vlerësim objektiv, duke përmbushur qëllimin thelbësor të Aneksit 6, i cili ka për synim sigurimin e të dhënave të domosdoshme për një analizë të paanshme dhe të drejtë të ofertave. Pretendimi i operatorit ankues, se dokumentet nuk janë paraqitur në formën e kërkuar, nuk është i qëndrueshëm, pasi, sipas ekspertit, tabela e dorëzuar ka përmbushur qëllimin e saj në tërësi. Si rrjedhojë eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka vepruar në përputhje me nenin 7 dhe 59 dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

Pretendimi i dytë - "Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin që ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale me FDT është kërkuar: Për (LOT-1) & (LOT-3) Kërkesa 2 Staf Profesional i kualifikuar. 2.1 Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës ose master drejtimi energjetike me 5 vite përvojë pas diplomimit. Te jete menaxher i projektit.; 2.2 Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës ose master drejtimi energjetike me 5 vite përvojë pas diplomimit.; 2.3 Një inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë ose master konstruktiv me 3 vite përvojë pune pas diplomimit.; 2.4 Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master konstruktiv 5 vite përvojë punë pas diplomimit i certifikuar për sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Të jetë udhëheqës i punishtes. Për (LOT-1) & (LOT-3) Dëshmia 2: 2.1 Lista e Stafit e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Diploma e noterizuar nga origjinali, certifikatat e noterizuara nga origjinali, kontrata e noterizuar në prani të dy palëve ose parakontrata për projekt e noterizuar në prani të dy palëve dhe CV e nënshkruar nga vet inxhinieri. Vendimi për menaxher dhe udhëheqës të projektit e noterizuar në prani të dy palëve. Te gjitha diplomat universitare jashtë shtetit të Kosovës, duhet të nostrifikohen. Sa i përket pretendimit për stafin e OE të rekomanduar për kontratë (Inxhinierin e ndërtimtarisë ose master konstruktiv sipas kërkesës 2.3) për këtë pozite është dorëzuar diploma e F.K e cila është për titullin Bachelor i Ndërtimtarisë – drejtimi Konstruktiv. Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e FDT-se ka qenë "inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë ose master konstruktiv" përderisa diploma e Inxhinierit është në bachelor. Vlerësimi i AK-se se e njëjta i plotëson kërkesat e FDT-se nuk është i drejtë sepse niveli bachelor është më i ultë se ajo që është kërkuar përmes FDT-së. Prandaj bazuar në dëshmitë e ngarkuara në eprokurim eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar në përputhje me nenin 40.2 dhe 40.6 të RRPP 01/2022 dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Pretendimi i tretë - "Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin që ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale me FDT është kërkuar: Për (LOT-1) & (LOT-3) Kërkesa 3 Staf Teknik. 3.1. Dy elektrikist të trajnuar për punime në lartësi dhe përdorimin e P.M.I për mbrojtjen e rënies nga lartësia; 3.2. Një elektrikist i certifikuar në programin e efijencies të energjisë. Për (LOT-1) & (LOT-3) Dëshmia 3 Lista e stafit teknik e vulosur dhe nënshkruar. Stafit teknik të dëshmohej me diplomat të noterizuar, si dhe me kontrata punë aktive të noterizuar ose marrëveshje për bashkëpunim e noterizuar. I gjithë stafit teknik duhet të jenë të trajnuar me certifikata për siguri dhe mbrojtje në punë - certifikatat e noterizuar. Licenca e noterizuar e kompanisë nga MPMS që ka lëshuar këto certifikata. Eksperti shqyrtues sqaron se me ofertë OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar stafin teknik që sipas kërkesës se FDT-se dhe listës se dorëzuar i përgjigjet stafit: S.H. – Teknik i Elektros, L.K. – Teknik i elektros, Ç.Z. Teknik i elektros. Kërkesa e FDT-se ka qenë që numri i stafit teknik të jetë tre (3). Përkundër faktit se OE ankues i referohet tërë listës në përgjithësi dhe emrave të përveçëm në veçanti eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa e FDT në këtë pikë ka të bëjë me tre punëtor teknik

dhe dëshmia rrjedhimisht është kërkuar për tre punëtor teknik. Eksperti shqyrtues pas administrimit të provave; ofertën e OE të rekomanduar për kontratë konstaton se stafi teknik me inicialet L.K dhe S.H nuk posedojnë certifikata për mbrojtje dhe siguri në punë sikurse është kërkuar me FDT. Po ashtu edhe pretendimi për kontratë dhe marrëveshje të bashkëpunimit për dy tekniket e elektros Ç.Z. dhe S.H është i qëndrueshëm sepse kontratat nuk janë të noterizuara sipas kërkesës së FDT-së. Prandaj bazuar në sqarimet si më lartë eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar në përputhje me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 40.2 dhe 40.6 të RRPP 01/2022 dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Pretendimi i katërt - "Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin që ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale me FDT është kërkuar: Për (LOT-1) & (LOT-3) Kërkesa 5 Min. 8 punëtor ndihmës me kontratë të punës aktive, të trajnuar për siguri dhe mbrojtje në punë dhe se paku 2 prej tyre të jetë i trajnuar për përdorim të aparateve kundër zjarrit Për (LOT-1) & (LOT-3) Dëshmia 5 Lista e stafit ndihmës e vulosur dhe nënshkruar. Të dëshmohet me kontratë pune të aktive të noterizuara si dhe me certifikata për siguri dhe mbrojtje në punë si dhe përdorim të aparateve kundër zjarrit - certifikatat e noterizuara. Eksperti shqyrtues sqaron se me ofertë OE të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën me 14 pjesëtarë të stafit. Gjashtë prej tyre janë pjesë e listës së stafit profesional që janë kërkuar në FDT. Pjesa tjetër prej 8 pjesëtarëve të stafit janë lista e kërkuar me kërkesën e FDT-së (5). Nga kjo listë certifikata valide për mbrojtje dhe siguri në punë kanë vetëm shtatë prej tyre. Stafi teknik me inicialet S.H nuk posedon certifikatë sipas kërkesave të FDT-së. Prandaj duke u bazuar në sqarimet si më lartë eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk e ka vepruar në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së si dhe nenin 40.6 të RRPP 001/2022, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi i pestë- "Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë me sigurimin e tenderit sipas nenit 14.1 të kërkesave të FDT-së. OE ankues pretendon se sigurimin e tenderit i dhënë në vlerë të përgjithshme të tri Lot-ve është në kundërshtim me nenin 57 të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron se OE të rekomanduar për kontratë në oferte ka dorëzuar sigurimin e tenderit me nr. Serik. 10001123131 lëshuar nga Prisig në vlerë prej 6,000.00 €. Njoftimi për kontratë ka përcaktuar se oferta mund të dorëzohet për të gjitha pjesët. Në kërkesat e FDT-së apo në njoftimin për kontratë AK nuk e ka specifikuar ndonjë kërkesë specifike që ka të bëjë me sigurimin e tenderit prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se sigurimi i tenderit i ofruar nga OE të rekomanduar për kontratë është në përputhje me nenin 28 të RRPP 001/2022, rrjedhimisht pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues, andaj paneli shqyrtues pa nevojë për sqarime tjera shtesë e vlerëson si të bazuar ankesën e OE ankues anulon njoftimin për dhënie të kontratës, ndërkaq aktivitetin e prokurimit e kthen në rivlerësim.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Boge me nr. të prokurimit: 635-24-8403-5-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BK – CONSTRUCTION” SH.P.K dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BK – CONSTRUCTION” SH.P.K janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Boge me nr. të prokurimit: 635-24-8403-5-2-1 të kthehet në rivlerësim si

dhe AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Boge me nr. të prokurimit: 635-24-8403-5-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës (Lot1) dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - BK - CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: